



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punimja/Prudato Received / Deliverty	26.10	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSTICK	6483/2022		119	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.795/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi- anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.795/2022 të datës 12.09.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati në Komunën e Vitisë, kundër organit të punësimit Komuna e Vitisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.10.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.795/2022 e datës 12.09.2022, e parashtruar nga ankuesi;
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.108/2022 i datës 09.09.2022, i nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Vitisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij të inicoj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit-ankuesit nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Vitisë, sipas Akt emërimit AE.Nr.33/2021 të datës 30.07.2021 në pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Inspektime”. Me datën 05.08.2022 fillimisht





ka parashtruar kërkesën me numër 02-320/04-32747 tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore lidhur me harmonizimin e koeficientit nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë (8).

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, konform kërkesës së ankuesit të datës 05.08.2022 me datën 12.09.2022 ka nxjerrë Vendimin 02-035/02-1007, sipas te cilit e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën e ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit nga 7.5 në 8.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 19.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 26.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankuesit nga Komuna e Vitisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 5318/2022 të datës 12.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 02-035/02-1007 të datës 22.02.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë; Kërkesën e ankuesit me numër të protokollit 02-320/04-32747 e parashtruar tek Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë; Konkursin me numër reference RN00006936 të datës 21.05.2021; Akt emërimit e ankuesit me numër AE.Nr.33/2021 te datës 30.07.2021; Konkursin me numër reference RN00007317 të datës 21.07.2021; Akt emërimit me numër AE.Nr.48/2021 të datës 02.09.2021; Akt emërimit me numër 02-112/999 te datës 03.12.2013; Akt emërimit me numër 02-112/1002 te datës 03.12.2013; Akt emërimit me numër 07-112/2389 të datës 30.12.2011; Akt emërimit me numër 06-112/2484 te datës 30.12.2011; Liste me nëpunësit në Komunën e Vitisë; Konkursin me numër reference RN00006893 te datës 19.05.2021; Konkursin me numër reference RN00007936 te datës 01.12.2021; Konkursin me numër reference RN00008652 te datës 22.03.2022; Shkresën zyrtare me numër Nr.Prot.6038 të datës 27.11.2014 nga MAP; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.09.2022 nga Komuna e Vitisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se organi i punësimit respektivisht Komuna e Vitisë ka aplikuar koeficient të ndryshëm lidhur me pozitat e udhëheqëseve të sektorëve brenda këtij institucioni si pozita të



kategorisë së njëjtë të punës, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale të siguruar nga ana e ankuesit, ka konstatuar se sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.48/2021 të datës 02.09.2021 Udhëheqësi i Sektorit të Tatimit në Pronë ka koeficient 8 të pagës, Udhëheqësi i Zhvillimit Ekonomik sipas Akt emërimit me numër 06-112/2484 të datës 30.12.2011 ka koeficient 8 të pagës, Përgjegjësi i Zyrës Ligjore Akt emërimit me numër 02-112/999 të datës 03.12.2013 ka koeficient 8 të pagës, ndërsa ankuesi në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Inspektive, sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.33/2021 të datës 30.07.2021 ka koeficient 7.5 të pagës. Kështu që bazuar në këto fakte, Kolegji vlerëson së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit brenda të njëjtit institucion dhe një veprim/mosveprim i tillë i organit të punësimit është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 2 ku përcaktohet se: *Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, ...të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:..... 3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës; si dhe nenin 4 paragrafi 1 të të njëjtit ligj ku thuhet se: "Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*

Kolegji me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me çështjen ankimore të ankuesit, mori parasysh shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 20.11.2014 të lëshuar nga drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP, për Sekretarët e Përgjithshëm, Drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe Menaxherët e Personelit të institucioneve publike përmes të cilës shkresë janë vendosur koeficientet e pozitive përkatëse rrjedhimisht për pozitën Udhëheqës i sektorit është vendosur koeficient tetë pikë pesë (8.5). Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, i cili me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ka kërkuar harmonizimin e koeficientit nga koeficienti 7.5 në 8, Kolegji ka konstatuar se bazuar në shkresën e lart cekur për pozitën e ankuesit parashihet koeficienti tetë pikë pesë 8.5 e jo tetë (8) siç pretendon ankuesi, andaj mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si më lartë, Kolegji vlerësoj se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Vitisë me rastin e mos harmonizimit të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar edhe kundërshtim me nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.108/2022 të datës 09.09.2022, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kundërshtim edhe me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.





Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.795/2022, datë 25/10/2022

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.